



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1332/6 prot

Datë 06.06.2024

V E N D I M

Nr. 631/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.06.2024 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-01610-04-16-2024, me objekt “*Blerje kancelari*”, me fond limit 1 556 550 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë, me adresë: Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë.

Ankimues: Operatori Ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, me NUIS J62426002Q, me adresë: Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, me NUIS L91418502J, me adresë Zona Kadestrale nr.8517, e llojit trull plus ndertese 4 kate, me siperfaqe trualli 1’000 m2 dhe siperfaqe ndert., Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

- II.1. Në datën 17.04.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01610-04-16-2024, me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 1 556 550 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.
- II.2. Në datën 15.05.2024, autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave dhe operatorët ekonomikë ofertues janë njoftuar për klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

“Librari Dyrrahu” SHPK	905.100,00 lekë, kualifikuar
“InfoSoft Office” SHPK	1.547.290, 75 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 22.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit.

II.4. Në datën 28.05.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1332/2024 protokollin dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4127 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01610-04-16-2024 me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 1 556 550 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Library Dyrrahu” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Pasi u njohem me vendimin e Komisionit të vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Library Dyrrahu” SHPK, vlerësojme, se ky vlerësim është bërë në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, e konkretisht vlerësimi i gabuar është bërë në lidhje me plotësimin nga ky ofertues të kriterëve për kualifikim si më poshtë:.”

I. Nuk ka argumentuar në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP cmimet anomalisht të uleta të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

Ne lidhje me pretendimin tonë se, ofertuesi “Library Dyrrahu” SHPK, nuk ka argumentuar në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP cmimet anomalisht të uleta të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, argumentojme si më poshtë vijon:

SE PARI:

Ne këtë procedurë prokurimi ofertuesi “Library Dyrrahu” SHPK ka ofertuar me vlerën e ofertës 905,100 (nëntëqind e pesë mijë e njëqind) leke pa TVSH nga : 1,556,550 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) leke pa TVSH, të përlogaritura për këtë procedurë prokurimi nga autoriteti kontraktor. Vlera e ofertuar nga ofertuesi “Library Dyrrahu” SHPK për realizimin e kësaj procedurë prokurimi është sa 58 % e fondit limit, me e ulet se 75 % e fondit limit, pra rezultoi të jetë ofertë anomalisht e ulet në kushtet kur në këtë procedurë prokurimi ka vetëm 2 oferta të kualifikuara. Ne besojmë se, shoqëria “Library Dyrrahu” SHPK, nuk ka arritur të argumentojë konform kërkesave të nenit 93 të LPP-se cmimet e ofertuar në këtë procedurë prokurimi. Referuar vlerave të ofertave të kualifikuara rezultoi se, oferta e ofertuesit “Library Dyrrahu” SHPK jo vetëm që është ofertë me cmime anomalisht të uleta pasi ajo është me e ulet se 75% e fondit limit, por është një ofertë me cmime të pajushtifikuara dhe të paargumentuara pasi sic e cituam edhe më lart ajo është vetëm 58 % e fondit limit, pra ka një ulje prej 42% nga fondi limit.

NE nenin 93 (Oferta anomalisht e ulet) të LPP-se, në lidhje me ofertat anomalisht të uleta percaktohet si më poshtë:

Ë...1. Kur autoritetet ose entet kontraktore verejne se oferta per punet, furnizimet ose sherbimet eshte anomalisht e ulet, i kerkon operatorit ekonomik te paraqese me shkrim dhe brenda tri diteve pune shpjegime per cmimin ose kostot e propozuara ne oferte. 2. Shpjegimet e permendura ne piken 1 jepen veçanerisht per: a) anen ekonomike te procesit te prodhimit, te sherbimeve te ofruara ose te metodes se ndertimit; b) zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes; c) origjinalitetin e punes, furnizimeve ose sherbimeve te propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes; d) mundesine e ofertuesit per te marre ndihme shteterore. 3. Autoriteti ose enti kontraktor vlereson informacionin e dhene, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzoje oferten kur, edhe pas shqyrtimit te provave te dhena nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj, duke marre ne konsiderate elementet e permendura ne piken 2 te ketij neni...”.

Ne nenin piken 4 te nenit 82 “Shqyrtimi dhe vleresimi i ofertave” te VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Pas korigjimit te gabimeve aritmetike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon nese ofertat e vlefshme jane ose jo me cmim anomalisht te ulet sipas formulese percaktuar ne dokumentet standarde te tenderit. Perlllogaritja e ofertes anomalisht te ulet behet ne menytrat e meposhtme: - Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 93, te LPP-se, oferta vleresohet anomalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 25% e fondit limit te perlllogaritur; - Ne rastin kur jane te vlefshme tri ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 93, te LPP-se, oferta vleresohet anomalisht e ulet nese vlere e saj do te jete me e vogel se 85% e mesatares se ofertave te vlefshme. Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 93, te LPP-se.

Ne cdo rast, ofertuesi ka detyrimin te argumentojte dhe te dokumentojte me prova shkresore, sqarimet per elementin/elementet e veçanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 93, te LPP-se?E

Ne keto kushte ofertuesi “Library Dyrrahu” SHPK, ka detyrimin te argumentojte, te provojte me dokumente shkresore plotesimin e te kater kushteve te percaktuara ne shkronjat a, b, c, te pikes 2, te nenit 93 te LPP-se, ne menyre kumulative. Ne zbatim te nenit nenit 93, pika 1 te ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, barra e proves mbi argumentin e ofertes anomalisht te ulet i perket operatorit ekonomik, oferta e te cilit eshte konstatuar nga Komisioni I vleresimit te Ofertave si anomalisht e ulet. Argumentimi i ofertes anomalisht te ulet njeherazi duhet te plotesojte kater kushte kumulative per ti dhene garanci dhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do te permbushe me sukses kontraten.

Operatori ekonomik duhet te dorezoje ne menyre te detajuar anen ekonomike te metodes te sherbimeve te ofruara, gjithashtu duhet te paraqese para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve dhe sherbimeve. Gjithashtu eshte detyre e ofertuesit oferta e te cileve eshte konstatuar anomalisht e ulet te paraqese prova shkresore para autoritetit kontraktor ne lidhje me origjinalitetin e punes, furnizimeve ose sherbimeve te propozuara

nga ofertuesi. Ai duhet te vertetojne pajtueshmerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes, ne vendin ku do te sigurohet furnizimi si edhe se fundmi te argumentojne apo provojne mundesine e tyre per te perfituar ndihme shteterore.

Ne besojme se, ofertuesi "Library Dyrrahu" SHPK, nuk ka arritur te argumentoje me prova shkresore se, me cmimet anomalisht te uleta te ofertuara prej tij e ka te mundur te realizoje me sukses objektin e prokurimit, duke garantuar njekohesisht, plotesimin e te gjitha kerkesave te percaktura nga AK-ja ne dokumentat e tenderit te kesaj procedure prokurimi. NE germen a) te pikes 2 te nenit 93 te LPP, kerkohet te argumentohet me prova shkresore nga ofertuesi ana ekonomike e sherbimeve te ofruara, pra kerkohet qe te paraqitet nje analize e detajuar e kostove te furnizimeve zerat e ofertes, per te gjithë elementet ne trajte analitike, pra ofertuesi duhet te argumentoje me prova dhe fakte se mund ta realizoje me sukses, objektin e prokurimit me cmimin e ofertuar per cdo ze. Kjo procedure prokurimi ka per objekt furnizimin me kancelari ku perfshihet tonera dhe artikuj te tjere kacelarie, e konkretisht jane 66 (gjahstedhete e gjashte) lloje per te cilat duhet te argumentoje cmimet e tij.

Shoqeria jone ka nje kohe te gjate qe operon ne tregun shqiptar, eshte nje nga kompanite lider ne kete fushe, njeh shume mire tregun dhe kompanite konkurente qe operojne ne kete fushe dhe nisur nga kjo ne besojme se, ofertuesi "Library Dyrrahu" SHPK, e ka te pamundur te realizoje kete kontrate me cmimet e ofertuara. Ne germen a) te pikes 2 te nenit 93 te LPP, kerkohet te argumentohet me prova shkresore nga ofertuesi ana ekonomike e sherbimeve te ofruara, pra kerkohet qe te paraqitet nje analize e detajuar e kostove te furnizimeve per seicilin ze te ofertes, per te gjithë elementet ne trajte analitike, pra ofertuesi duhet te argumentoje me prova dhe fakte se mund ta realizoje me sukses, objektin e prokurimit me cmimin e ofertuar per cdo ze. - dokumentacion provues ne lidhje me cmimet me te cilat siguron 66 llojet e artikujve te kancelarise te deklaruar ne oferte dhe te cilat duhet te plotesojne kerkesat e specifikimeve teknike. - dokumentacion provues ne lidhje me kostos e tjera te ofertes me qellim dhenien e garancive per realizimin me sukses dhe me cilesine e kerkuar ne DT nga autoriteti kontraktor.

Nder 66 artikujt e kancelarise te kerkuara nga AK-ja, jane kekruar edhe artikujt e meposhtem: Artikulli me Nr. Rendor 11 (Qese plastike A4), me specifikimet teknike: ipako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhesi A4, me spesor jo me pak se 100 mikron. Keto qese mund te perdoren me te gjitha llojet e lidhasve te unazave si nje menyre per te mbrojtur dhe renditur dokumentet. Cdo qese te kete kapacitet mbajtes jo me pak se 40 flete A4 80gm2 secila.e Artikulli me Nr. Rendor 18 (Makine kapese Aktesh (Stapler)), me specifikimet teknike: makina per kapse aktesh (Stapler), te jete metalike dhe me material Aelik i pandryshkshem ose i kromuar ne forme pince. Makina te jete pershtatshme per te kapur minimalisht 45 flete te gramatures 80 gr/m2. Gjithashtu ajo duhet to kapi dhe me pak fleta ne varesi te perdorimit duke nderruar numrin e telave. Te perdoret me tela/kapese 24/6, 26/6, 26/8 dhe 24/8. Artikulli me Nr. Rendor 27 (Makine profesionale per te hapur vrimat ne dokumenta per dosjet me mekanizma) me specifikimet teknike: ihapesi i vrimave te letres te jete i bere nga materiali metalik, qe perdoret per te hapur vrima dopjo ne leter A5-A3 deri ne 150 letra te gramatures 80 gr/m2 njeheresh. (Diapazoni i hapjes se vrimave ne leter nuk ka kufizim nga 1 deli ne 150 letra, por ne 150 letra njeheresh duhet to

realizojë shpimin e tyre, edhe nëse ka kapacitet me të madh shpimi mbi 150 letra 80 gr/m² konsiderohet në përputhje me specifikimet teknike). Të jete i pajisur me distanciator për të zgjedhur llojin e letres që do të hapen dopjo vrimate Artikulli me Nr. Rendor 61 (Karte identifikuese punonjesh) me specifikimet teknike: i-karta identifikuese duhet të jete prej kartoni të fortë me masë jo më pak se 300g/m², me permasa 9cmx6cm dhe të jete e pajisur me mbajtëse të plastifikuar dhe rrip me gjerësi 1.5cm-2cm dhe perimenter 80cm-90cm ngjyre portokalli/ kuqe për vendosje rreth qafes me logon Bashkia Tirane. Rripi me mbajtësen e plastifikuar të lidhen me njëra-tjetren me mekanizëm metalik me hapje manuale dhe mbyllje automatike. Permbajtja e kartave do jete e printuar me ngjyra nga të dyja anët dhe do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dispozicion nga autoriteti kontraktore. Për 4 (kater) artikujt e mesiper, ofertuesi “Library Dyrrahu” SHPK, ka ofertuar me çmime shumë të ulëta në raport me çmimet me të cilat mund të sigurosh këto artikuj në treg, apo në raport me kostot e domosdoshme për prodhimin e tyre dhe që të plotësojnë të gjitha specifikimet teknike të percaktura nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 të DT-se.

Në jemi të bindur që ky ofertues, ka paraqitur çmime shumë të ulëta, çmime që nuk mbulojnë as kostot e tyre pasi janë disa here më të ulëta se çmimet me të cilat realisht mund të sigurosh këto artikuj, pra janë çmime për artikuj të cilët nuk i plotësojnë kërkesat e percaktuara nga AK-ja dhe kjo është edhe arsyeja se përse ky ofertues ka ofertuar me çmime shumë të ulëta. Për artikullin me numer rendor 61 (Karte identifikuese punonjesh), artikull për të cilin në shtojcën 5 të DT-se janë percaktuar specifikimet teknike: i-karta identifikuese duhet të jete prej kartoni të fortë me masë jo më pak se 300g/m², me permasa 9cmx6cm dhe të jete e pajisur me mbajtëse të plastifikuar dhe rrip me gjerësi 1.5cm-2cm dhe perimenter 80cm-90cm ngjyre portokalli/ kuqe për vendosje rreth qafes me logon Bashkia Tirane. Rripi me mbajtësen e plastifikuar të lidhen me njëra-tjetren me mekanizëm metalik me hapje manuale dhe mbyllje automatike. Permbajtja e kartave do jete e printuar me ngjyra nga të dyja anët dhe do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dispozicion nga autoriteti kontraktore, ofertuesi “Library Dyrrahu”, ka ofertuar me një çmim për njësi që është shumë here më i vogël se sa kostoja për prodhimin e tij. Çmimi për njësi i ofertuar për këto artikull nuk mbulon as koston e plastifikimit të tij e jo me kostot e prodhimit të kartave identifikuese për punonjësit, të cilat duhet të jene të individualizuara për çdo punonjës, kostot e kartonit me cilesinë dhe permasat e kerkuara, kostot e mbajtësës të plastifikuar, të rripit për vendosje rreth qafes, i cili duhet të kete gjerësi 1.5cm-2cm dhe perimenter 80cm-90cm, të jete me ngjyre portokalli/ kuqe dhe të kete logon e bashkisë Tirane. Në besojmë se, ofertuesi “Library Dyrrahu” SHPK, jo vetëm për artikujt e mesiper por edhe për artikujt e tjere nuk ka arritur të argumentojë me prova shkresore se mund ta realizojë objektin e kesaj procedure prokurimi me artikujt me të cilët ka ofertuar çmime shumë të ulëta pasi këto artikujt me këto çmime nuk plotësojnë njëkohësisht të gjitha specifikimet teknike të artikujve të percaktura në dokumentat e tenderit. Për gjithë sa më sipër argumentuam, në besojmë se, “Library Dyrrahu”, e ka të pamundur ta realizojë kontratën objekt prokurimi sipas kushteve, cilesisë së kerkuar në dokumentat e tenderit me një vlerë të ofertes e cila është 58 % e fondit limit. Kjo ulje kaq e madhe nga ky operator ekonomik, sjell një risk të madh për autoritetin kontraktor në lidhje me mundësinë e madhe të deshtimit dhe të mosrealizimit me sukses të kesaj procedure prokurimi, duke i sjelle në këte mënyrë autoritetit kontraktor, demë të medha të cilat lidhen me mosfunksionimin normal të institucionit, nisur nga natyra e kesaj kontrate. Në besojmë se,

ky ofertues nuk ka arritur te argumentoje me prova shkresore se, me cmimet anomalisht e uleta te ofertuara prej tij e ka te mundur te realizoje me sukses objektin e prokurimit, duke mos ceduar ne cilesine e kerkuar, duke garantuar njekohesisht, plotesimin e te gjitha kerkesave te percaktura nga AK-ja ne dokumentat e tenderit te kesaj procedure prokurimi, qe lidhen jo vetem me sigurimin e te gjithe artikujve te kancelarise por edhe shperndarjen e tyre sipas afateve dhe adresave te percaktuara ne shtojcen 6 te DT-se.

SE DYTI:

Rocedura e prokurimit objekt i ketij ankimi eshte publikuar ne SPE me date 17.04.2024, pra hedhur ne SPE pas dates 20.03.2024, date ne te cilin kane hyre ne fuqi ndryshimet e ligjit te prokurimit publik. Referuar procesverbalit te hartimit te dokumentave te tenderit te publikuar ne SPE, rezulton se ai eshte i dates 15.04.2024, pra ne besojme se ne kete procedure prokurimi duhet te ishin zbatuar dispozitat e ligjit Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik" i ndryshuar me Ligjin Nr.16/202 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik". Ligji Nr.16/2024 "Per r disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publike, i cili eshte publikuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 40, date 04.03.2024, ka hyre ne fuqi ne date 20 Mars 2024, me perjashtim te neneve te percaktuara ne piken 2, te nenit 54 te ketij ligji. Referuar ndryshimeve ligjore e konkretisht ne Nenin 27 te Ligjit Nr.16/2024 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 162/2020 iper prokurimin public" percaktohet si me poshte vijon:

Ne nenin 93 pas pikes 4 shtohet pika 5 me kete permbajtje:

5. Ne procedurat e prokurimit me vlere nen kufijte e larte monetare, autoritetet ose entet kontraktore refuzojne pa kerkuar shpjegime nje oferte, e cila eshte konstatuar anomalisht e ulet.e.

Sa me siper, ne kushtet kur oferta e ofertuesit "Library Dyrrahu" SHPK, eshte oferte anomalisht e ulet pasi ajo eshte ne vleren nen 75% te fondit limit, ne kushtet kur jane te kualifikuara vetem dy oferta, atehere Komisioni i vleresimit te Ofertave, ne zbatim te pikes 5 te nenit 93 te ligjit Nr.162/2020 iper prokurimin publike, i ndryshuar, duhet te kishte vendosur skualifikimin e ofertes se paraqitur nga ky ofertues, pa i kerkuar asnje shpjegim. [...]

Per gjithe sa me siper argumentuam, ne pretendojme se, gjate vleresimit te ofertes se ofertuesit "Library Dyrrahu" SHPK, KVO ne autoritetin kontraktor ka shkelur ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Per gjithe sa me siper, kerkojme: - ndryshimin e vendimit te KVO-se, duke vendosur s'kualifikimin e ofertes te paraqitur nga ofertuesi "Library Dyrrahu", ne proceduren e prokurimi me objekt "Blerje kancelari", REF-01610-04-16-2024, me fondin limit 1,556,550 (nje milion e peseqind e pesedhete e gjashte mije e peseqind e pesedhete) leke pa TVSH, te zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e pergjithshme e Bbjekteve Publike, Bashkia tirane, si nje oferte anomalisht e ulet e paargumentuar ne perputhje me pikat 1, 2 dhe 3 te nenit 93 te LPP-se, ne rast se, procedura e prokurimit ka nisur perpara dates 20 Mars 2024; - Ose ne alternative, ne rast se, procedura e prokurimit ka nisur pas dates 20 mars 2024, ndryshimin e vendimit te KVO-se, duke vendosur s'kualifikimin e ofertes te paraqitur nga ofertuesi "Library Dyrrahu", si nje oferte anomalisht e ulet, ne zbatim te pikes 5 te nenit 93 te Ligjit Nr.162/2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar.

II.5. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1332/2 prot., datë 29.05.2024, me kriteret që operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK , kundërshton me anë të ankesës me nr. 1332 prot.

II.6. Në datën 05.06.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1332/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 2289/4 prot., datë 31.05.2024, me objekt: “*Kthim - përgjigje ankesës së operatorit ekonomik*”, drejtuar operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik. Referuar kësaj shkrese rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Library Dyrrihu” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 2289/4 prot., datë 31.05.2024, me objekt: “*Kthim - përgjigje ankesës së operatorit ekonomik*”, drejtuar operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për dijeni KPP-së dhe protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1332/3 prot., datë 05.06.2024, rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK .

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-01610-04-16-2024, me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 1 556 550 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK , lidhur me procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-01610-04-16-2024, me objekt “*Blerje kancelari*”, me fond limit 1 556 550 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK .
4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

